



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.13

16 shkurt

2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MF & METE nr.1, datë 8.1.2007	Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë	207
Udhëzim i MF, MB & METE nr.1, datë 23.1.2007	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.703, datë 11.10.2006 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore, që i nënshtrohen privatizimit apo transformimit të tyre në shoqëri tregtare”.....	211
Udhëzim i MPCSSH nr.203, datë 1.2.2007	Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.873, datë 27.12.2006 “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”	213
Vendim i KNSH nr.8, datë 2.2.2007	Për skemën ekzistuese të subvencionimit të hekurudhave.....	215
Vendim i KNSH nr.9, datë 2.2.2007	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për masën e financimit, kriteret për procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit	216

Vendim i KNSH nr.10, datë 2.2.2007	Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për grantin “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë”	218
Vendim i KKRT nr.554, datë 29.1.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Ngjallja”	219
Vendim i KKRT nr.555, datë 29.1.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Saranda”	220
Vendim i KKRT nr.556, datë 29.1.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Top Gold”	220
Vendim i KKRT nr.557, datë 29.1.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Club FM”	220
Vendim i KKRT nr.558, datë 29.1.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Radio Ime”	221
Vendim i KKRT nr.559, datë 29.1.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Magic Star”	221
Vendim i KKRT nr.560, datë 29.1.2007	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Alfa&Omega”	222
	Shpallje kërkesë për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të rrugës nga kthesa e repartit ushtarak deri në impiantin e Bovillës.....	222
	Shpallje kërkesë për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronareve znj.Feride Irahim Bego dhe znj.Myrifete Iliaz Peshtani, që preken nga zgjerimi i varrezave të Burdulliasit, në bashkinë Berat.....	223

UDHËZIM
Nr. 1, datë 8.1.2007

**PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME ANKAND TË PAKETAVE SHTETËRORE TË
AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE QË VEPROJNË NË SEKTORËT
JOSTRATEGJIKË**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.3.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve në shoqëritë tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.119, datë 27.2.2003 dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.776, datë 11.10.2006, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

I. PROCEDURAT PËR PËRGATITJEN E DOKUMENTACIONIT PËR PRIVATIZIM

A) PRIVATIZIMI I PAKETAVE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE

1. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nxjerr urdhrin për përgatitjen e dokumentacionit të privatizimit të shoqërisë tregtare.

2. Në zbatim të këtij urdhri, i cili i dërgohet shoqërisë, drejtoria e shoqërisë përgatit dokumentacionin që duhet të përmbajë dosja për privatizim, si më poshtë:

a) Aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë;

b) Vendimin e regjistrimit të shoqërisë si person juridik në gjykatë, me ndryshimet e bëra në të;

c) Bilancin e shoqërisë;

d) Raportin e ekspertit kontabël;

e) Genplanin ose planvendosjen e shoqërisë, të lëshuar nga zyra e urbanistikës së qytetit/rrethit përkatës;

f) Aktvlerësimin e truallit të shoqërisë;

g) Vërtetimin nga Qendra e Regjistrimit të Aksioneve për regjistrimin e shoqërisë që privatizohet, kur shoqëria ka mbi 50 aksionarë;

l) Aktin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të shoqërisë në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, së bashku me hartën treguese.

3. Dosja e përgatitur nga drejtoria e shoqërisë dërgohet në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në dy kopje origjinale ose të njësuara me të.

4. Dokumentacioni i paraqitur kontrollohet nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për rregullsinë e tij. Kur dokumentacioni gjendet me mangësi, i kërkohet drejtorisë së shoqërisë që të plotësohet konform kërkesave të vendimit nr.119, datë 18.3.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

5. Kur dokumentacioni është i plotë dhe i rregullt, përgatitet urdhri i Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për fillimin e procedurave të privatizimit të shoqërisë tregtare.

6. Brenda 5 ditëve nga dalja e këtij urdhri, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dërgon dokumentacionin e privatizimit të shoqërisë në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike pranë Ministrisë së Financave.

7. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me marrjen e përfundimit të llogaritjeve të kërkesave për aksione nga punonjësit e shoqërisë dhe ish-pronarët e truallit, kërkon mendimin e organit të varësisë administrative për paketën e aksioneve shtetërore dhe pas marrjes së këtij informacioni Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës përcakton formulën e privatizimit dhe nxjerr urdhrin lidhur me të.

8. Me daljen e urdhrit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dërgon dosjen e privatizimit në Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike).

B) PRIVATIZIMI I PAKETËS SË AKSIONEVE QË I OFROHET BLERËSIT TË VETËM

1. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës:

a) Mbi bazën e numrit të punonjësve dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre, përllogarit madhësinë e mundshme të paketës së aksioneve për punonjësit e shoqërisë.

b) Mbi bazën e vlerës së truallit të shoqërisë, përllogarit madhësinë e mundshme të paketës për ish-pronarët e truallit.

2. Pas përllogaritjeve sipas pikës 1, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës përcakton madhësinë e paketës që i ofrohet blerësit të vetëm, pa cenuar të drejtat e punonjësve dhe ish-pronarëve të truallit të shoqërisë. Mbi këtë bazë Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nxjerr urdhrin e privatizimit të paketës së aksioneve që i ofrohet blerësit të vetëm.

3. Procedurat për privatizimin e paketës së aksioneve që i ofrohen blerësit të vetëm bëhen sipas pikave 1 deri 6 të kapitullit A të këtij udhëzimi.

C) PRIVATIZIMI I PAKETËS SË AKSIONEVE PËR PUNONJËSIT E SHOQËRISË DHE ISH-PRONARËT E TRUALLIT

1. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nxjerr urdhrin për privatizimin e paketës së aksioneve për punonjësit dhe ish-pronarët e truallit.

2. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dërgon këtë urdher në Ministrinë e Financës (Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) për vazhdimin e procedurave sipas përcaktimeve të pikave B, C të kapitullit të I-rë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.3.2000, të ndryshuar.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pas marrjes së rezultateve të llogaritjeve të kërkesave për aksione nga punonjësit dhe ish-pronarët e truallit të shoqërisë, ndjek zbatimin sipas pikave 7 dhe 9 të kapitullit “A” të këtij udhëzimi.

II. PROCEDURAT PËR PËRCAKTIMIN E FORMULËS SË PRIVATIZIMIT NGA MINISTRIA E FINANCAVE (DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ADMINISTRIMIT DHE SHITJES SË PRONAVE PUBLIKE)

A) PUBLIKIMI

1. Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, pasi gjen të rregullt dokumentacionin e privatizimit dërguar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përgatit materialin që do të publikohet sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 2 germa “A” të kapitullit të I-rë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.3.2000, të ndryshuar.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike e publikon këtë material:

- në Buletinin Zyrtar;
- në faqen e internetit;
- në mediat elektronike;
- nëpërmjet vendosjes së afisheve pranë shoqërive që privatizohen, si dhe në mjediset publike të vendndodhjes së subjektit.

Ky material duhet të përmbajë, veç elementeve të publikimit, dhe treguesit tekniko-ekonomikë të shoqërisë sipas bilancit të vitit të fundit ushtrimor.

3. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në fund të periudhës së publikimit, harton një procesverbal në lidhje me procedurën e publikimit.

B) PROCEDURAT E LLOGARITJES SË PAKETËS SË AKSIONEVE PËR PUNONJËSIT E SHOQËRISË DHE ISH-PRONARËT E TRUALLIT

1. Me fillimin e publikimit, Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, përcakton tipin e formularit (Listën e punonjësve me anëtarët e familjes së tyre) për punonjësit e shoqërisë dhe ua dërgon atë shoqërive që do të privatizohen.

2. Siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.3.2000, të ndryshuar, kapitulli i I-rë germa “B” pika 4, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, brenda 25 deri 30 ditëve nga data e I-rë e publikimit, pranon porositë e aksioneve nga punonjësit e shoqërive dhe anëtarët e familjeve të tyre në këmbim të bonove të privatizimit.

3. Gjatë periudhës së pranimit të kërkesave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike plotëson formularin në tri kopje, me germa të mëdha shtypi, pa korrigjime, i cili nënshkruhet si nga porositësi, ashtu edhe nga punonjësit e kësaj drejtorie, duke u vulosur nga kjo e fundit.

4. Dy kopje të formularit të plotësuar mbahen në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike dhe një kopje e merr porositësi.

5. Në prani të porositësit, bonot e privatizimit të dorëzuara nga porositësi bëhen të pavlefshme duke e grisur deri në gjysmën e tyre vertikalisht dhe duke e vulosur me vulën e pavlefshme. Brenda ditës, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike plotëson tabelën përmbledhëse (tabela nr.1).

6. Data e fillimit të regjistrimit të kërkesave për aksione të shoqërive tregtare njoftohet nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike gjatë publikimit.

7. Nuk lejohet të pranohen kërkesa për aksione pas datës së fundit të regjistrimit të njoftuar në publikim. Çdo kërkesë e pranuar jashtë këtij afati është e pavlefshme.

8. Në zbatim të pikës 4 germa "C" të kapitullit të I-rë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.3.2000, të ndryshuar, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, me shkresë, i kërkon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronës dhe zyrës së urbanistikës së organeve të pushtetit vendor përditësimin e pronave të ish-pronarëve në genplanin e shoqërisë që privatizohet.

C) FORMULA E PRIVATIZIMIT

1. Një ditë pas përfundimit të afatit 30-ditor, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike mbledh të gjithë dokumentacionin e grumbulluar për punonjësit e shoqërisë dhe ish-pronarët e truallit.

2. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike merr në dorëzim dhe kontrollon listën e punonjësve dhe anëtarëve të familjeve të tyre të plotësuar nga shoqëritë tregtare në 1 kopje. Ajo harton tabelën përmbledhëse (tabela nr.1) në dy kopje, duke i bashkëlidhur certifikatat e gjendjes familjare të punonjësve të shoqërisë që privatizohet; formularët e regjistrimit të kërkesave për aksione.

3. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike merr në dorëzim dhe kontrollon: bonot e privatizimit që shoqërojnë formularët e regjistrimit të kërkesave për aksione; destinat e bonove të privatizimit me listën përmbledhëse të tyre.

4. Pas kontrollit dhe marrjes në dorëzim të të gjitha materialeve, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike bën krahasimin e të gjithë treguesve për sasinë e bonove të privatizimit të dorëzuara me vlerën që rezulton nga formularët përkatës dhe tabelat përmbledhëse etj.

5. Në fund të këtij procesi bëhet një procesverbal përsa më sipër nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike. Pas kësaj Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme në Ministrinë e Financave, bën dorëzimin e bonove të privatizimit pranë Bankës së Shqipërisë.

6. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, brenda 10 ditëve nga data e mbylljes së regjistrimit të kërkesave, përgatit materialin përmbledhës për punonjësit e shoqërisë dhe ish-pronarët e truallit, bën llogaritjet dhe nxjerr rezultatet përkatëse.

7. Gjithashtu brenda 15 ditëve nga data e nxjerrjes së rezultateve Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike bën përpunimin dhe llogaritjet përkatëse, të cilat më pas i dërgon në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

III. PROCEDURAT PËR ZBATIMIN E KAPITULLIT TË DYTË TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.119, DATË 18.3.2000, TË NDRYSHUAR, NGA MINISTRIA E FINANCEVE/DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE SHITJES SË PRONAVE PUBLIKE

1. Pas mbarimit të afatit të publikimit nga Ministria e Financave/Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, hartohet procesverbali i publikimit.

2. Pjesëmarrësit në ankandin për shitjen e paketës së aksioneve që i ofrohet blerësit të vetëm, dorëzojnë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2 germa "A" të kapitullit 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.3.2000, të ndryshuar, para komisionit të ankandit. Dokumentacioni kontrollohet nga të gjithë anëtarët e komisionit të ankandit, ndërsa dokumenti bankar kontrollohet edhe nga punonjësi i sektorit të financës, i cili bën pjesë në komisionin e ankandit.

3. Me pjesëmarrësit në ankand nënshkruhet aktmarrëveshja e hartuar nga Ministria e Financave/Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike për kushtet e pjesëmarrjes në ankand.

4. Gjatë zhvillimit të ankandit, sekretari i komisionit të ankandit mban procesverbalin, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe nga pjesëmarrësit në ankand. Me të dhënat e këtij procesverbali plotësohet raporti për përfundimin e ankandit, i cili firmoset nga anëtarët e komisionit të ankandit dhe nga fituesi i tij.

5. Ministria e Financave/Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, menjëherë me fillimin e procedurave të publikimit të shitjes për paketat e aksioneve shtetërore në shoqëritë pjesërisht të privatizuara, njofton shoqërinë dhe këshillin mbikëqyrës të saj për organizimin e mbledhjes së aksionarëve, në përputhje me ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", për prononcimin zyrtar të aksionarëve në lidhje me blerjen e paketës së aksioneve me çmimin e arritur në ankand.

6. a) Ish-pronarët e truallit si subjekte kërkuese kanë të drejtë të marrin aksione të shoqërisë në bazë të sipërfaqes së truallit, të përcaktuar në vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, brenda kufizimit të shoqërisë dhe çmimit të truallit të përcaktuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.703, datë 11.10.2006 "Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve që i nënshtrohen privatizimit apo transformimit të tyre në shoqëri tregtare".

Në zbatim të pikës 7 të këtij vendimi, trualli në shoqëritë tregtare me kapital 100% shtetëror do të rivlerësohet sipas akteve ligjore në fuqi. Shtimi i vlerës së truallit në bilancin e shoqërisë, në aktivin e saj, do të reflektohet si shtesë në kapitalin e shoqërisë.

b) Për shoqëritë anonime pjesërisht të privatizuara, te të cilat u janë transferuar aksionet ish-pronarëve të truallit, ky vendim nuk merr përsipër të bëjë kompensim.

c) Për shoqëritë anonime pjesërisht të privatizuara, te të cilat nuk janë transferuar aksionet ish-pronarëve të truallit, rritja e vlerës së truallit, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.703, datë 11.10.2006 "Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe shitjes së trojeve", do të vendoset në mbledhjet e jashtëzakonshme të asamblesë së aksionarëve të shoqërive në bazë të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", duke zbatuar dispozitat e seksionit 6 nënseksioni "Zmadhimi i kapitalit".

Në këtë rast ish-pronarët e truallit:

- kanë të drejtë të marrin aksione në përpjesëtim me vlerën e truallit të llogaritur sipas akteve në fuqi, vetëm në rast se vendoset zmadhimi i kapitalit në mbledhjen e jashtëzakonshme të aksionarëve me votat që kërkohen për ndryshimet në statut.

- do të paguhet në *cash* në rast se në asamble vendoset që vlera e rivlerësuar e truallit të pasqyrohet në pasiv të bilancit si detyrim i shoqërisë.

d) Në rast se në mbledhjen e asamblesë nuk vendoset dy rastet sipas germës "C", atëherë ish-pronarët do të kompensohen, duke kaluar në favor të tyre, për aq sa i takon, pjesë nga paketa e mbetur e aksioneve shtetërore në shoqëritë anonime.

8. Për pikën 12 të vendimit sqarohet se ripublikimi do të bëhet edhe në rast se në ankand paraqitet një kërkesë e vetme.

9. Për pikën 13 të vendimit: Në qoftë se pas 2 publikimeve të Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike për shitjen e paketave të aksioneve nuk paraqitet asnjë kërkesë, atëherë shoqërisë mund t'i bëhet një vlerësim nga një grup ekspertësh të pavarur kontabël dhe vlerësues pasurie të emëruar me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Vlerësimi do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për ta ofruar shoqërinë për shitje nëpërmjet sugjerimit të vlerës reale, gjë që do të vendosë pritshmërinë e shitjes.

Rekomandohen si metoda më bashkëkohore vlerësimi: vlera e kapitalizuar e shoqërisë, duke reflektuar në kapitalin themeltar shtesat ose pakësimet e zërave brenda kapitaleve të veta të shoqërisë; vlera aktuale e tregut nëpërmjet shitjeve krahasuese; pasqyra e cash-it; treguesit e performancës etj.

Me paraqitjen e raportit të ekspertëve për këtë vlerësim, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës urdhëron privatizimin nëpërmjet ankandit të paketës shtetërore të aksioneve.

10. Procedura e caktimit të ekspertëve për misionin e vlerësimit të shoqërisë, për efekt të shitjes së paketës së aksioneve shtetërore dhe miratimi i raportit të tyre bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare (Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike). Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, lidh kontratë me ekspertët për misionin e vlerësimit të shoqërisë. Pagesa e ekspertëve do të bëhet në përputhje me tarifën e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dhe Shoqatës së Vlerësuesve. Kontrata kalon për ndjekje Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

11. Në rastin kur ish-pronarët e truallit nuk përfitojnë nga procedurat e përmendura në kapitullin III pika 6/c të këtij udhëzimi, ata do të kompensohen në një nga format e përcaktuara në ligj nëpërmjet Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS
Genc Ruli

UDHËZIM
Nr. 1, datë 23.1.2007

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.703, DATË
11.10.2006 “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT DHE TË SHITJES SË
TROJEVE TË NDËRMARRJEVE SHTETËRORE, QË I NËNSHTROHEN PRIVATIZIMIT
APO TRANSFORMIMIT TË TYRE NË SHOQËRI TREGTARE”**

Në zbatim të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.703, datë 11.10.2006 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore, që i nënshtrohen privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare”, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme

UDHËZOJNË:

1. Truall që privatizohet konsiderohet sipërfaqja nën objekt dhe sipërfaqja funksionale rreth tij, e përcaktuar sipas genplanit të objektit që është pjesë e dokumentacionit të privatizimit, që përgatit komisioni i vlerësimit të ndërmarrjes, sipas pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.703, datë 11.10.2006 (sipas ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar).

2. Kur ish-pronari i truallit është bërë pronar i objektit, duke përdorur të drejtën e parablerjes sipas pikës 2 të kapitullit të III-të të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.704, datë 11.10.2006, trualli kalon në favor të tij pa shpërblim. Ndërsa kur ish-pronarët e truallit nuk kanë përfutur objekt në trojet ish-pronë e tyre, u lind e drejta e kompensimit fizik për të shlyer trojet e shitura, siç përcaktohet në nenin 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”.

3. Kur objekti është me 2 a më shumë kate dhe në të ka disa pronarë, atëherë shitja e truallit, në bazë të kërkesës së tyre për çdo pronar, bëhet në bashkëpronësi të pandashme mes pronarëve të objektit. Bashkëpronarët iu nënshtrohen dispozitave të Kodit Civil, p.sh.:

- Objekti me 3 kate është ndërtuar mbi një sipërfaqe 500 m² (sipërfaqe ndërtimi + mjedisin e përbashkët + sipërfaqen e bordurës + sipërfaqen e truallit në oborr, nëse ka).

- Sipërfaqja e ndërtimit, pa ambientet e përbashkëta, është 1250 m² dhe për çdo kat është: kati I-rë, 450 m²; kati II-të, 450 m² dhe kati III-të, 350 m².

Llogarisim koeficientin (k)

$$K = \frac{\text{Sipërfaqe trualli}}{\text{Sipërfaqe ndërtimi}} \qquad K = \frac{500 \text{ m}^2}{1250 \text{ m}^2} \qquad K = 0.4$$

Koeficienti është konstant, duke u shumëzuar me sipërfaqet përkatëse të ndërtimit që zë secili pronar, jep sipërfaqen përkatëse që i takon të privatizojë secili pronar. Në një kat mund të ketë një ose më shumë pronarë. Në rastin tonë në shembull kemi vetëm nga një pronar në çdo kat. Konkretisht:

$$\text{Për katin e I-rë: } 450 \text{ m}^2 * 0,4 = 180 \text{ m}^2$$

$$\text{Për katin e II-të: } 450 \text{ m}^2 * 0,4 = 180 \text{ m}^2$$

$$\text{Për katin e III-të: } 350 \text{ m}^2 * 0,4 = 140 \text{ m}^2$$

Këto sipërfaqe, duke u shumëzuar me çmimin për m², të llogaritur nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës ish-Pronarëve, japin vlefën që duhet të paguajë në lekë secili pronar.

4. Në publikim, krahas VAM-it, do të përfshihet dhe vlefë e shitjes së truallit me sipërfaqen përkatëse. Vlera e shitjes së truallit do të përfshihet në VAM. Në rast se në dosjen e privatizimit nuk gjendet dokumentacioni i plotë, i përcaktuar në pikën 1, 2 dhe 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.704, datë 11.10.2006, atëherë u kërkohet degëve të shoqërive publike, sipas përkatësisë së ndërmarrjes, brenda 2 muajve nga dalja e këtij udhëzimi, të saktësojnë dhe të plotësojnë dokumentacionin.

5. Në rastet kur një ndërmarrje është privatizuar ose do të privatizohet, të mbahet parasysh ndarja e sipërfaqes së truallit që shërben për rrugë kalimi të përbashkët. Në këtë rast sipërfaqja e truallit do të shitet në bashkëpronësi në mes tyre, në raport me sipërfaqen që ato kanë në pronësi. Për këtë duhet të sjellin nga seksioni i urbanistikës së pushtetit vendor, konfirmimin për përcaktimin e kësaj sipërfaqjeje në bashkëpronësi.

6. Në zbatim të pikës 3/d kapitulli i IV-t, data e deklaratës noteriale origjinale, që blerësi nuk ka proces gjyqësor për objektin dhe truallin përkatës që kërkon të blejë, duhet të jetë jo më pak se një ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për blerjen e truallit.

7. Në zbatim të pikës 5 kapitulli i IV-t, për rastet e sipërfaqeve shtesë të dala nga rimatja e sipërfaqeve të trojeve për objektet e privatizuara, brenda kufizimeve të përcaktuara nga hartat treguese të lëshuara nga ZRPP-ja, pasi këto shtesa të verifikohen dhe të pasqyrohen në procesverbal të veçantë si të tilla, nga matjet në vend që do të realizohen nga komisioni, sipas përcaktimit në këtë pikë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.703, datë 11.10.2006, atëherë Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, fillon procedurat e shitjes sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim, duke filluar me kërkesën për ribërjen e genplanit të objektit në zyrat e urbanistikës së organit të pushtetit vendor përkatës.

TË PËRGJITHSHME

1. Në zbatim të kapitullit V pika 3, nuk do të zbatohen procedurat e vlerësimit të trojeve të objekteve si më poshtë:

a) Për trojet e objekteve që nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit kanë filluar procedurat e shitjes së tyre (janë publikuar për shitje). Pra janë publikuar për shitje në fazën me VAM fillestar dhe do të vazhdojë publikimi edhe sipas fazave me “ulje VAM-i” apo me “rezervë”.

b) Trojet e objekteve të privatizuara dhe për të cilat janë depozituar aktet e vlerësimit të trullit pranë Ministrisë së Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike deri një ditë para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Në rastet kur mungon dosja e privatizimit të objektit për arsye objektive pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike në Ministrinë e Financave, kopja e dosjes së vlerësimit (privatizimit) të objektit ose ndërmarrjes kërkohet nga degët e shoqërive publike, ZRPP-ve në juridiksionin e së cilës ndodhet objekti ose zyrave noteriale. Kur dhe aty nuk gjendet dosja e vlerësimit (privatizimit) të objektit, atëherë Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave kryen procedurat e privatizimit të trullit mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga pronari i objektit (kontrata e shitjes së ndërmarrjes ose objektit, akti i dorëzimit, autorizimi për kalim pronësie, genplani, mandatpagesat etj.) të njohura këto me vendim gjykate të formës së prerë.

3. Për të gjitha dosjet e objekteve të dërguara për privatizim nga ish-Ministria e Ekonomisë në ish-AKP Tiranë gjatë vitit 2005, procedurat e privatizimit të tyre do të fillojnë nga Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, pasi të jetë plotësuar edhe me formularin e ri për çmimin e trullit nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve.

4. Të gjitha dosjet e objekteve të dërguara për privatizim në ish-Ministrinë e Ekonomisë dhe që janë konstatuar të rregullta do të përcillen në Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike) pasi të jenë plotësuar edhe me formularin e ri për çmimin e trullit nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I BRENDSHËM
Sokol Olldashi

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS
Genc Ruli

UDHËZIM
Nr. 203, datë 1.2.2007

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.873, DATË
27.12.2006 “PËR MASËN E FINANCIMIT, KRITERET DHE PROCEDURAT E ZBATIMIT
TË PROGRAMEVE TË PRAKTIKAVE PROFESIONALE PËR PUNËKËRKUESIT E
PAPUNË, QË KANË MBARUAR ARSIMIN E LARTË, BREND APO JASHTË VENDIT”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të pikës 11 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.873, datë 27.12.2006 “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit” dhe të nenit 18/1 të statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave, datë 17.1.1998 “Për miratimin e statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, të ndryshuar”,

UDHËZOJ:

1. Shërbimi Kombëtar i Punësimit, brenda datës 1 prill 2007, të mbledhë nga rektoratet listat e të diplomuarve në 24 muajt e fundit, të cilat, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave, janë të detyruara t’i paraqesin ato në zyrat përkatëse të punësimit.

2. Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në fund të vitit akademik, të përditësojë listat e të diplomuarve të atij viti.

3. Në bazë të listave të rektorateve, zyrat përkatëse të punësimit krijojnë listat e punëkërkesve të papunë, të diplomuar në 24 muajt e fundit, në bazë të vendbanimit të tyre dhe i regjistrojnë ata sipas kodeve të profesioneve. Regjistrimi bëhet vetëm në një zyrë dhe kjo mund të jetë çdo zyrë rajonale apo vendore punësimi ku ka vendbanimin punëkërkuasi.

4. Listat të kenë një renditje përparësie, duke bërë përzgjedhjen e tyre sipas pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave. Pra të renditen të parët në listë:

- 1) punëkërkuasit me rezultate më të mira (mesatarja);
- 2) punëkërkuasit, familjet e të cilëve përfitojnë ndihmë ekonomike;
- 3) punëkërkuasit që bëjnë pjesë në grupet e veçanta, të përcaktuara në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit” (ndryshimet e vitit 2006).

Pasi të kenë përfunduar kategoritë e mësipërme, listat vazhdojnë sipas mesatares.

5. Për të diplomuarit jashtë vendit, personat duhet të paraqesin njohjen e diplomës nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe regjistrimi bëhet pasi është paraqitur dokumenti që vërteton njohjen e saj. Këta punëkërkuas të papunë regjistrohen në listat e krijuara nga zyrat e punësimit sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, në bazë të vendbanimit sipas kodeve të profesioneve dhe kritereve të pikës 4 të po këtij udhëzimi.

6. Drejtoria e Përgjithshme e SHKP-së drejton procesin e hartimit të listave të ndërmarrjeve nga zyrat e punësimit, pasi të kenë marrë nga këto institucione aprovimin për numrin e punëkërkesve që ato mund të pranojnë për të kryer praktikat profesionale. Listat e institucioneve duhet të përmbajnë, të paktën, emrin e institucionit, aktivitetin që kryen dhe numrin e kursantëve që pranon. Listat me përmbajtjen e mësipërme u dërgohen rektorateve, të cilat duhet t'i shpallin ato në mjediset e fakulteteve. Vetë zyra e punësimit bën publikimin e listave të institucioneve qofshin këto publike apo private, në media apo dhe në ambiente publike.

7. Punëdhënësit publikë janë të detyruar t'i marrin falas në mjediset e tyre punëkërkuasit e papunë, sipas raportit të vendosur në pikën 6 të vendimit.

8. Zyra e punësimit ndërmjetëson, në çdo rast, me punëdhënësit për pranimin e punëkërkesve të papunë, sipas listave që disponon. Punëkërkuasi i papunë mund të zgjedhë vetë punëdhënësin dhe i kërkon zyrës së punësimit të ndërmjetësojë për pranimin e tij.

9. Në rastin kur zyra e punësimit ka rënë dakord me punëdhënësin për pranimin e punëkërkesve të papunë për kryerjen e praktikave profesionale pas paraqitjes së dokumenteve, si një kopje të certifikatës së regjistrimit në organin tatimor, numrin e llogarisë bankare dhe deklaratën e vënies në dispozicion të një kujdestari nga ana e punëdhënësit, e miraton atë në komisionin përkatës të zyrës rajonale të punësimit.

10. Pas miratimit nga komisioni përkatës, lidhet marrëveshja ndërmjet zyrës përkatëse të punësimit, punëdhënësit dhe punëkërkuasit të papunë. Këto marrëveshje janë të vlefshme vetëm për vitin kalendarik. Për vitin pasardhës lidhet marrëveshje e re. E njëjta praktikë si më sipër ndiqet dhe për punëdhënësit publikë, pavarësisht se nuk ka detyrime financiare.

11. Përparësitë dhe fushat prioritare ku do të zbatohet programi vendosen me urdhër të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta çdo fillim viti.

12. Në zbatim të pikës 7 të vendimit, për çdo praktikant, punëdhënësi privat përfiton kompensim çdo muaj në masën 100% të nivelit bazë të pagesës së papunësisë. Kompensimi jepet vetëm në rastet kur plotësohet kushti i pikës 8 të vendimit. Kompensimi jepet pasi punëkërkuasi të paraqesë në zyrën e punësimit vërtetimin nga punëdhënësi për ditët e ndjekjes së praktikës profesionale për muajin paraardhës.

13. Zyra përkatëse e punësimit kryen pagesat e punëkërkesve të përfshirë në këtë program çdo muaj, në masën 100% të nivelit bazë të pagesës së papunësisë, pasi punëkërkuasi të paraqesë në këtë zyrë vërtetimin nga punëdhënësi për ditët e ndjekjes së praktikës profesionale për muajin paraardhës. Kohëzgjatja javore e praktikës profesionale është 40 orë në javë.

14. Zyra përkatëse e punësimit bën derdhjen e kontributit për sigurimin nga aksidentet në punë, në masën 0.5 për qind të pagës minimale për çdo punëkërkuar të papunë të përfshirë në program. Vlera e këtij kontributi derdhet në degën e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit përkatës.

15. Në rastet kur punëkërkuarët largohen nga praktika profesionale, punëdhënësi duhet të bëjë njoftim në zyrën e punësimit. Kursantët e larguar nuk zëvendësohen.

16. Praktika profesionale e financuar nga zyra e punësimit kryhet vetëm një herë.

17. Zyra kompetente e punësimit përpilon dhe dërgon çdo muaj në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit informacione në lidhje me projektet, personat e përfshirë, punëkërkuarët e papunë etj.

18. Procedurat për përdorimin e fondeve të nxitjes së punësimit dhe hollësi të tjera përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministrit të Financave nr.1, datë 5.2.2001 “Për kriteret dhe procedurat e subvencionimit për të nxitur punësimin”.

19. Procedurat për zbatimin e këtij programi dhe marrëveshja tip përcaktohen me rregulloren metodike të zbatimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Marrëveshja tip të shërbejë vetëm si udhëzues për punonjësit e zyrave të punësimit, ndërkohë që kur ato lidhen me subjektin duhet të rishkruhen për çdo rast.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka

VENDIM
Nr. 8, datë 2.2.2007

PËR SKEMËN EKZISTUESE TË SUBVENCIONIMIT TË HEKURUDHAVE

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- z.Genc Ruli	Kryetar
- znj.Mimoza Dhëmbi	Anëtare
- znj.Mimoza Vokshi	Anëtare
- z.Viktor Gumi	Anëtar
- z.Ledi Bianku	anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 2.2.2007, shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese të subvencionimit të hekurudhave”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, me shkresën nr.4329/4, datë 16.8.2006 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.A1/05/2005.

Baza ligjore: Si bazë për dhënien e subvencionit të hekurudhave është ligji nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, si dhe udhëzimi nr.8, datë 27.1.2006 “Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2005”, si dhe të gjitha ligjet e buxhetit në vite.

Objektivi/at: Skema synon të ndihmojë Hekurudhën Shqiptare sh.a. duke i ofruar një subvencionim të përvitshëm nga Buxheti i Shtetit, në mënyrë që të kompensohen kostot e ofrimit të shërbimeve publike, në veçanti, mbulimin e shpenzimeve operative të shërbimit të transportit të udhëtarëve.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema mbulon sektorin e hekurudhave në vend, duke synuar mbulimin e një pjese të kostove të ofrimit të shërbimeve publike për transportin e udhëtarëve.

2. Skema mund të justifikohet për shkak të natyrës së saj, për kontributin që jep në zhvillimin rajonal, pasi kjo masë klasifikohet si një shërbim me interes të përgjithshëm ekonomik.

3. Në dhënien dhe zbatimin e skemës në vite nuk ka pasur një plan zhvillimi të sektorit, ka munguar analiza e treguesve ekonomik-financiarë të ndërmarrjes së hekurudhave dhe për shumë vjet ndërmarrja nuk ka pasur në dispozicion fondet e nevojshme për mirëmbajtjen dhe investimet, të domosdoshme për ta shndërruar atë në një ndërmarrje eficiente.

4. Nuk ka masa konkrete për zbatimin e nenit 63 pika 1 të Kodit Hekurudhor, të miratuar me ligjin nr.9317, datë 18.11.2004 në lidhje me përcaktimin e tarifave të ofrimit të shërbimit të transportit të udhëtarëve. Duke qenë se për hekurudhat është ende në fuqi kontrolli i çmimeve, Hekurudha Shqiptare nuk është e lirë të caktojë vetë tarifat për mallrat dhe udhëtarët, gjë që sjell që të ardhurat mesatare për njësi trafiku në Shqipëri të jenë të ulëta.

5. Nuk ka një ndarje të llogarive për shërbimet e ofruara nga Hekurudha Shqiptare sh.a. në mënyrë që të përaktohet saktë kostoja e ofrimit të shërbimit publik (transportit të udhëtarëve) dhe të shmanget çdo mbikompensim, që mund të vijë për shkak të problemeve të ndryshme, përfshirë keqmenaxhimin në vite.

6. Nuk ka masa me afate konkrete për liberalizimin e sektorit, hapjen e tij për konkurrencë dhe as për ndarjen e menaxhimit të infrastrukturës nga shërbimet e tjera që ofron transporti hekurudhor.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, mbështetur në nenin 13 shkronja “c” dhe nenin 23 të ligjit nr.9374, datë 21.2.2005 “Për ndihmën shtetërore”,

PROPOZON:

1. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, brenda datës 31 mars 2007, të lidhë kontratën publike me Hekurudhën Shqiptare sh.a., në të cilën të përcaktohet qartë detyrimi i Hekurudhës Shqiptare sh.a. për të ofruar shërbimin publik të transportit të udhëtarëve.

2. Të bëhet ndarja e llogarive për pjesën që i takon transportit të udhëtarëve nga veprimtaritë e tjera të Hekurudhës Shqiptare brenda datës 31 korrik 2007, në mënyrë që të përcaktohen saktë kostot e ofrimit të shërbimit publik. Të bëhet llogaritja e saktë e vlerës së kompensimit që Hekurudha Shqiptare mund të përfitojë për të ofruar këtë shërbim publik.

3. Në rast se nuk do të kompensohet e gjithë shuma e nevojshme për ofrimin e shërbimit publik të transportit të udhëtarëve, atëherë të lejohet Hekurudha Shqiptare të përshtatë tarifat për vlerën e pambuluar nga subvencioni.

4. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të marrë të gjitha masat, deri në fund të vitit 2007, për përgatitjen e një plani për zhvillimin e sektorit hekurudhor, në mënyrë që ai të hapet për konkurrencë, duke filluar nga ndarja e menaxhimit të infrastrukturës prej shërbimeve të tjera të transportit hekurudhor.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM
Nr. 9, datë 2.2.2007

**PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE PËR MASËN E FINANCIMIT,
KRITERET PËR PROCEDURAT E ZBATIMIT TË PROGRAMIT TË PRAKTIKAVE
PROFESIONALE PËR PUNËKËRKUESIT E PAPUNË, QË KANË MBARUAR ARSIMIN E
LARTË BRENDIA APO JASHTË VENDIT**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- z.Genc Ruli	Kryetar
- znj.Mimoza Dhëmbi	Anëtare
- znj.Mimoza Vokshi	Anëtare
- z.Viktor Gumi	Anëtar
- z.Ledi Bianku	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 2.2.2007, shqyrtoi raportin “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për masën e financimit, kriteret për procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda dhe jashtë vendit”. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me shkresën nr.2495, datë 12.12.2006 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.2, datë 13.12.2006.

Baza ligjore: Si bazë për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për masën e financimit, kriteret për procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda dhe jashtë vendit, është neni 9 pika 2 e ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar me ligjin nr.9570, datë 3.7.2006.

Objektivi/at: Objektivi kryesor i ndihmës është përgatitja e fuqisë punëtore, në veçanti të rinjve, nëpërmjet programeve aktive, të cilat do të ndikojnë në zgjidhjen e problemit të papunësisë dhe rritjen profesionale të tyre.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Ndhimja për masën e financimit, kriteret për procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit, synon të jepet:

a) në formën e financimit të drejtpërdrejtë, për çdo punëkërkues të papunë, në masën e nivelit bazë të pagesës së papunësisë, në vlerën 5240 lekë/muaj, për një periudhë deri më 6 muaj, dhe

b) për punëdhënësit privatë, në masën e nivelit bazë të papunësisë, sipas numrit të praktikantëve çdo muaj.

2. Për komponentin e parë, janë përcaktuar drejt dhe pa diskriminimin kategoritë e punëkërkuesve që mund të përfitojnë nga skema.

3. Përsa i takon mbështetjes së punëmarrësve, skema përfshin ndërmarrjet që, në kuptimin e legjislacionit të ndihmës shtetërore, janë kryesisht ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Ato do të përfitojnë një vlerë prej 5240 lekë/muaj, që llogaritet si niveli minimal i pagës, plus sigurimet shoqërore të punës për çdo të trajnuar. Ato nuk do ta përfitojnë këtë vlerë monetare dhe asnjë lloj tjetër përfitimi nëse nuk vendosin një kujdestar që të përgjigjet për menaxhimin e procesit të trajnimit të përgjithshëm të kësaj kategorie punëkërkuesish.

4. Madhësia e intensitetit të ndihmës për ndërmarrjet që përfitojnë nga skema nuk i kalon 35%, që është më i ulët se intensiteti maksimal i lejuar në dispozitat e legjislacionit të ndihmës shtetërore.

5. Skema është në kuadrin e një strategjie për punësimin, me qëllim që t'i japë shtysë këtij objektivi për disa kategori punonjësish, të tillë si: të sapodiplomuarit, apo punonjësit e rinj sezonalë, të cilët kanë vështirësi për të hyrë në tregun e punës. Për këtë arsye ka shkak të përligjur që autoritetet publike të zbatojnë masa, të cilat sigurojnë stimuj si për punëkërkesit për rritjen e nivelit të kualifikimit të tyre, ashtu edhe për ndërmarrjet, për të rritur nivelin e tyre të punësimit, veçanërisht të punonjësve nga kategoritë e mësipërme.

6. Skema është në përputhje me kërkesat e legjislacionit europian për ndihmën shtetërore për nxitjen e punësimit dhe ndihmën shtetërore për trajnim të punëkërkesve në vështirësi.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, mbështetur në nenin 7 shkronja “a”, nenin 11 shkronja “b”, nenin 13 shkronja “ç”, nenin 21 dhe nenin 32, pika 1, të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin për dhënien e ndihmës shtetërore në formën e skemës së përcaktuar në pikën 7 dhe 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.837, datë 27.12.2006 “Për masën e financimit, kriteret për procedurat e zbatimit të programit të praktikave profesionale për punëkërkesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”. MPÇSSHB të raportojë deri më 31 mars të çdo viti pranë DNSH, për ndihmën e dhënë nga zbatimi i kësaj skeme gjatë vitit paraardhës financiar.

2. Pika 9 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.873, datë 27.12.2006, lidhur me mbështetjen e drejtpërdrejtë të punëkërkesve të papunë, përbën një skemë ndihme të lejueshme. MPÇSSHB, të raportojë deri më 31 mars të çdo viti pranë DNSH, për ndihmën e dhënë nga zbatimi i kësaj skeme gjatë vitit paraardhës financiar.

3. MPÇSSHB të mbajë në një regjistër të veçantë të gjitha të dhënat për aplikimet individuale në kuadër të skemave dhe t'i ruajë ato për një periudhë 10-vjeçare, që llogaritet nga data në të cilën është dhënë ndihma e fundit individuale në secilën prej skemave.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

VENDIM Nr. 10, datë 2.2.2007

PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE PËR GRANTIN “PËR KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË”

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- z.Genc Ruli	Kryetar
- znj.Mimoza Dhëmbi	Anëtare
- znj.Mimoza Vokshi	Anëtare
- z.Viktor Gumi	Anëtar
- z.Ledi Bianku	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 2.2.2007, shqyrtoi raportin “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për dhënien e grantit “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë””. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore nga Drejtoria e Nxitjes së Biznesit në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me shkresën nr.511, datë 19.1.2007 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.3, datë 19.1.2007.

Baza ligjore: Si bazë për dhënien e grantit “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë” është ligji nr.9645, datë 27.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, si dhe projektvendimi “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë”.

Objektivat: Objektivi kryesor i skemës është rritja e aftësisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për të përballuar presionin konkurrues të tregut rajonal dhe europian, nëpërmjet rritjes së cilësisë së prodhimit e menaxhimit, integritit të tyre dhe nxjerrjes së produkteve që të përmbushin kërkesat e standardeve të këtij tregu.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Plani për dhënien e grantit “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë”, synon mbështetjen e veprimtarive që lidhen vetëm me:

- përmirësime teknologjike për përshtatje produkti, përfshirë ambalazhimin dhe etiketimin, certifikim produkti, vlerësim konformiteti dhe zbatim të sistemeve të cilësisë;
- shërbime këshillimore në formën e studimeve të tregut të trajnimeve;
- pjesëmarrjen për herë të parë jashtë shtetit, në një panair ose ekspozitë, si vizitor apo ekspozues.

2. Maksimumi i vlerës së grantit për një ndërmarrje të vetme është 1 000 000 lekë, gjë që nuk sjell ndikim të ndjeshëm në konkurrencë.

3. Skema ofron subvencionim për kosto që kanë të bëjnë me aktivitete rigorozisht të përcaktuara dhe, në asnjë rast, më shumë se 50% e kostove të pranueshme, pra funksionon mbi bazën e parimit të ndarjes së kostove.

4. Skema përcakton se përzgjedhja e ndërmarrjeve bëhet mbi bazë të respektimit të kushteve, të dhëna në mënyrë të përgjithshme dhe të pacaktuar.

5. Skema nuk ka karakter përzgjedhës për sektorë të veçantë, por përjashton një pjesë të ndërmarrjeve publike ose me kapital shtetëror, që nuk janë në proces privatizimi.

6. ALBINVEST do të jetë institucioni menaxhues i skemës, duke mos qenë vetë një përfitues i drejtpërdrejtë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, mbështetur në nenin 8 dhe nenin 22 pika 2 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”,

VENDOSI:

1. Të hiqet kushti i shprehur në shkronjën “a” të pikës 3 të projektvendimit “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë”.

2. Me zbatimin e pikës 1 të këtij vendimi, të miratojë planin për dhënien e grantit “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë”.

3. ALBINVEST të raportojë deri më 31 mars të çdo viti pranë DNSH, për ndihmën e dhënë nga zbatimi i kësaj skeme gjatë vitit paraardhës financiar.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Genc Ruli

VENDIM
Nr. 554, datë 29.1.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “NGJALLJA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.013/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë, subjektin “Ngjallja”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet e tij nga data 9.11.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ledi Bianku

VENDIM
Nr. 555, datë 29.1.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “SARANDA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.004/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë, subjektin “Saranda”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 9.11.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ledi Bianku

VENDIM
Nr. 556, datë 29.1.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “TOP GOLD”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.016/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë, subjektin “Top Gold”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 9.11.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ledi Bianku

VENDIM
Nr. 557, datë 29.1.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “CLUB FM”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.011/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë, subjektin “Club FM”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 9.11.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ledi Bianku

VENDIM
Nr. 558, datë 29.1.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “RADIO IME”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës të subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të rilicencimit sipas licencës nr.009/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë, subjektin “Radio Ime”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 9.11.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ledi Bianku

VENDIM
Nr. 559, datë 29.1.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “MAGIC STAR”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.003/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë, subjektin “Magic Star”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 9.11.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ledi Bianku

VENDIM
Nr. 560, datë 29.1.2007

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “ALFA&OMEGA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.010/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulimin në frekuencë, subjektin “Alfa&Omega”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet e tij që nga data 9.11.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ledi Bianku

SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të rrugës nga kthesa e repartit ushtarak deri në impiantin e Bovillës.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve sh.a. Tiranë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË RRUGËS NGA KTHESA E REPARTIT USHTARAK DERI NË IMPIANTIN E BOVILLËS

Nr.	Emri	Sipërfaqja tokë arë	Çmimi l/m ²	Vlera në lekë	Shënime
1.	Astrit Hoxha	40 m ²	700	28 000	Plotësim dokumentacioni
2.	Hasan Livadhi	458 m ²	700	320 600	Plotësim dokumentacioni
3.	Skënder Livadhi	640 m ²	700	448 000	Plotësim dokumentacioni
4.	Gani Lozi	330 m ²	700	231 000	Plotësim dokumentacioni
5.	Gëzim Livadhi	1020 m ²	700	714 000	Plotësim dokumentacioni
	Shuma	2 488		1 741 600	

Vlera totale e këtij shpronësimi është 1 741 600 lekë (një milion e shtatëqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind) lekë.

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajtshme të pronareve: Znj.Feride Ibrahim Bego dhe znj.Myrifete Iliaz Peshtani, që preken nga zgjerimi i varrezave të Burdulliasit, në bashkinë Berat.

Subjekti kërkues është bashkia Berat. Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni ka të bëjë me sipërfaqen që shpronësohet prej 2270 m².

Ky publikim do të jetë për një periudhë 1-javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personi që ka emrin, ka të drejtë të paraqesë pretendimet e tij, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Brendshme. Fatura, sipas formatit të mësipërm, t'i dërgohet për likuidim bashkisë Berat.

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE TË BURDULLIASIT NË BASHKINË BERAT

Nr.	Prona që do të shpronësohet	Njësia e matjes m ²	Sasia	Çmimi për njësi	Vlera në lekë	Emri i pronarit
1.	Truall	m ²	2 270	2 200	5 000 000	Feride Ibrahim Bega Myrifete Iliaz Peshtani
	Shuma				5 000 000	

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
 1. **PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) 1500**
 2. **PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600**
 3. **PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300**
 4. **PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500**

BOTIME TË REJA

1. **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
2. **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
3. **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000**
4. **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500**
5. **PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000**
6. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800**
7. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500**
8. **PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000**
9. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE..... 500**

Hyri në shtyp më 15.2.2007
 Doli nga shtypi më 16.2.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Grafon"
 Tiranë, 2007

Çmimi: 20 lekë